

OSBE: Normalizim i politikës në Shqipëri

Nga Arian Koçi

OSBE po ndihmon në reformën e ligjit zgjedhor

Ambasadori i OSBE-së në Tiranë, Osmo Lipponen, ka paraqitur një raport gjashtëmuor para Këshillit të Përhershëm të OSBE-së në Vjenë mbi gjendjen aktuale në Shqipëri dhe ristrukturimin e misionit të OSBE-së.

Në një intervistë për BBC-në, zoti Lipponen thotë se selia e OSBE-së në Vjenë i mbështet përpjekjet për normalizimin e klimës politike në Shqipëri dhe ai vetë shprehet optimist se marrëveshja Nano-Berisha për marrëdhënie konstruktive mes qeverisë dhe opozitës do të vazhdojë.

Zoti Lipponen po ashtu komenton edhe qëndrimin e OSBE-së për ligjin mbi ndarjen administrative.

BBC: Si e përshkruat gjendjen aktuale politike në Shqipëri para Këshillit të Përhershëm të OSBE-së?

Zoti Lipponen: Tema kryesore ishte se politikat konstruktive që po zhvillohen në kuadër të marrëveshjes Nano-Berisha i kanë çuar gjërat pozitivisht përpara. Megjithatë ka ende disa rryma që janë pak shqetësuese.

BBC: Kur flisni për këto rryma që janë shqetësuese, a e keni fjalën për zhvillimet e kohëve të fundit që zoti Nano dhe zoti Berisha thonë se kanë hequr dorë nga marrëveshja?

Zoti Lipponen: Në fakt ata nuk e thonë këtë. Mesa kuptoj unë ata duan që pala tjetër ta thotë. Besoj se marrëveshja është ende gjallë. Mesa i njoh unë, ata janë politikanë të përgjegjshëm, dhe në një farë mënyre nuk ka alternativë tjetër.

BBC: Ju thoni se marrëveshja është ende gjallë dhe vazhdon. A kanë kërkuar ata vetë ose njerëz të tyre që OSBE-ja të ndërmjetësojë në acarimin aktual të marrëdhënieve?

Zoti Lipponen: Unë zhvilloj diskutime normale me gjithkënd. Natyrisht që ajo është diskutuar. Unë e kuptoj se si e shohin ata njëri-tjetrin dhe ajo është mjaft pozitive, në sensin se pavarësisht nga opinionet e ndryshme që kanë, ata duan një qëndrim konstruktiv.

BBC: Atëhere, a mendoni se acarimet aktuale bëhen për shkak të zgjedhjeve të ardhshme lokale?

Zoti Lipponen: Natyrisht që zgjedhjet e ardhshme do të pasqyrohen në klimën dhe marrëdhëniet mes qeverisë dhe opozitës dhe për këtë arsye duhet të jemi gjakftohtë dhe të mos shkatërrohet procesi, sepse që pas marrëveshjes Nano-Berisha procesi ka qenë pozitiv dhe stabilizues në Shqipëri.

BBC: Në cilat fusha do të përqëndrohet puna e OSBE-së në të ardhmen?

Zoti Lipponen: Natyrisht që reforma e ligjit elektoral dhe zgjedhjet e ardhshme janë dy nga çështjet e mëdha që po shqyrtojmë pasi ato në një farë mënyre janë vendimtare për stabilitetin e ardhshëm politik të vendit. Po ashtu unë kam shprehur disa mendime për rindarjen administrative lokale.

BBC: Në këtë aspekt, zoti ambasador, OSBE-ja ka kritikuar ligjin për rindarjen administrative dhe ju e keni quajtur atë si të parakohshëm. Çfarë donit të thonit me këtë?

Zoti Lipponen: Unë nuk e quajta të parakohshëm. Unë thashë se koha nuk ishte e përshtatshme. Afati kohor që ata kanë vënë për këtë ndarje do të ishte para zgjedhjeve lokale. Reforma rajonale, dhe veçanërisht vendosja e autonomisë lokale nëpërmjet kompetencave të një administrate autonome lokale, është në interes të Shqipërisë dhe për atë ka nevojë Bashkimi Evropian.

BBC: Si u prit raporti juaj mbi gjendjen në Shqipëri nga Komisioni i Përhershëm i OSBE-së?

Zoti Lipponen: Vërtetë pata një surprizë pozitive, mora mbështetje unanime për reformat tona dhe pata një inkurajim që të vazhdojmë punën që po kryejmë në Shqipëri. Nuk e prisja një reagim kaq pozitiv dhe jam vërtetë i lumtur.

BBC: Zoti ambasador, ju dukeni mjaft optimist dhe pozitiv për gjasat e vazhdimin të marrëveshjes Nano - Berisha. A mendoni se marrëveshja do të vazhdojë pavarësisht nga deklaratat që po bëhen?

Zoti Lipponen: Duhet t'i shikojmë këto në një kontekst politik. Nuk është shumë i rëndësishëm fakti nëse marrëveshja është e pëlqyeshme për të gjitha fushat apo jo. Ky, sidoqoftë, është procesi i parë konsensual në politikën shqiptare për shumë kohë dhe për këtë arsye ka një vlerë që duhet respektuar dhe mbrojtur sa më gjatë që të jetë e mundur. Kjo sepse nuk shikoj alternativa të tjera për çështje kaq të rëndësishme të cilat nuk zgjidhen vetëm me shumica parlamentare, për çështje afatgjata e që krijojnë një atmosferë konstruktive. Në mbështetje 100 përqind normalizimin e gjendjes dhe rikthimin në demokraci normale dhe parlamentarizëm. Sipas traditave normale evropiane, kur vendos bazat e demokracisë si kushtetuta, kodi zgjedhor etj., pastaj duhet të ketë konsensus sepse kjo është baza e vetme e mirë për të vazhduar me ndërtimin e demokracisë.